

Ne fokus/ Tifozet e Tiranës “sulmojnë” sponsorin e Partizanit

nga AlbaniaSoccer
E martë, 22 Tetor 2013 22:19



Derbi mes Tiranës dhe Partizanit është një ndeshje e përjetshme që luhet edhe në distancë. Tifozet bardheblu kanë ndërmarrë një nisim të veçantë. Partizani ka lidhur një marrëveshje sponsorizimi me “Albtelecomin” pak ditë më parë, gjë e cila ka sjellë reagimin e tifozëve “Fanatics”. Bardheblutë për të sulmuar sponsorin e rivaleve të përjetshme kanë nisur të mbyllin numrat e telefonit dhe marrëveshjet që kanë me kompaninë turke “Albtelecom”. Duke e bërë këtë ata duan të sulmojnë këtë kompani që kontribuon për mirëqenien e Partizanit. Tani pritet kundërpergjigja e tifozëve të kuq për rivalët bardheblu.